


Integriteti i kandidatëve për Kryetarë të Komunave në **Zgjedhjet Lokale 2025**



Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Rreth IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi,
është organizatë jo-qeveritare dhe
jo-fitimprurëse e politikave publike,
fabrikë e mendimeve e specializuar
në sektorin e drejtësisë .

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Shtator, 2025

Prishtinë, Republika e Kosovës

Lista e shkurtesave

IKD	-	Instituti i Kosovës për Drejtësi
LVV	-	Lëvizja Vetëvendosje
PKD	-	Partia Demokratike e Kosovës
KQZ	-	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
PZAP	-	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Zyra	-	Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike
LS	-	Lista Serbe
DS	-	Demokracia Serbe
GJEDNJ	-	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Zgjedhjet lokale 2025	6
2.1.	Procesi i certifikimit.....	6
3.	Dekriminalizimi i politikës	9
4.	Kandidatët në problem me ligjin.....	11
5.	Kandidatët me aktakuza aktive	11
6.	Kandidatët me dënime penale	12
7.	Kandidatët me probleme me ligjin sipas komunave	14
8.	Kandidatët me probleme me ligjin sipas partive.....	14
9.	Kandidatët me probleme me ligjin sipas veprave penale.....	14
10.	Krahasimi me zgjedhjet paraprake.....	15

1. Përmbledhje ekzekutive

IKD ka avokuar vazhdimisht për dekriminalizimin e politikës, në kuptim që personat të cilët kanë probleme me ligjin, edhe nëse nuk kanë ndalesa specifike ligjore, mos të jenë pjesë e listave zgjedhore dhe bartës të funksioneve të caktuara publike. Problemet me ligjin konsistojnë qoftë në aktakuza aktive apo dënime të formës së prerë. Siç është theksuar vazhdimisht, kërkesa për mos kandidim të personave të cilët kanë probleme me ligjin nuk nënkupton cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë por se synon të dërgojë një mesazh pozitiv, në atë mënyrë që përderisa problemet me ligjin nuk përfundojnë, partitë politike nuk kandidojnë persona të tillë.

Me 12 tetor 2025, në Kosovë do të mbahen zgjedhjet lokale. Për këto zgjedhje lokale që do mbahen në 38 komunat e Republikës së Kosovës, nga KQZ janë certifikuar 93 subjekte politike. Prej tyre, 32 janë parti politike, 32 janë iniciativa qytetare, dy koalicione dhe 27 kandidatë të pavarur. Sikurse edhe në ciklet e tjera zgjedhore, edhe në këtë rast, IKD bazuar në të dhënat e saj të mbledhura nga procesi i monitorimit të gjykatave, në këtë raport ka paraqitur kandidatët për kryetarë të komunave të cilët kanë probleme me ligjin.

Bazuar në të dhënat e monitorimit të IKD, nga 206 kandidatët për kryetarë të komunave, tetë (8) prej tyre apo 3.9% janë persona të cilët kanë probleme me ligjin. Prej tyre, janë gjithsej katër (4) kandidatë të cilët kanë aktakuza aktive, mbi bazën e të cilave aktakuza edhe janë dënuar nga gjykata e shkallës së parë, por se këto dënime ose janë kthyer në rigjykim ose nuk kanë marrë formën e prerë. Ndërkaq, janë identifikuar edhe pesë (5) kandidatë që në të kaluarën janë dënuar me vendim të formës së prerë.

Tek kandidatët për kryetarë të komunave që IKD ka gjetur se kanë probleme me ligjin, përfshihen katër (4) kandidatë nga dy parti politike, tre (3) prej tyre nga PDK dhe një (1) nga LVV. Përderisa, tre (3) kandidatë janë nga tri iniciativa qytetare, Bashkimi Demokratik i Prizrenit, Srpska Narodna Sloga dhe Iniciativa Demokracia. Kurse, një (1) është kandidat i pavarur.

Sa i përket shtrirjes sipas komunave të kandidatëve që kanë probleme me ligjin, IKD gjen se kandidatë të tillë evidentohen në gjithsej shtatë (7) komuna. Kandidatët për kryetarë të komunave në zgjedhjet e 12 tetorit 2025 të cilët kanë probleme me ligjin janë akuzuar në 12 raste, për gjithsej 10 vepra të ndryshme penale.

Krahasimisht me zgjedhjet lokale të vitit 2021, IKD gjen se ka progres sa i përket numrit të përgjithshëm të kandidatëve me probleme me ligjin, numrit të kandidatëve me aktakuza aktive dhe numrit të komunave në të cilat garojnë kandidatë të cilët kanë probleme me ligjin. Progres poashtu vërehet edhe në numrin e partive politike që përfshijnë në listat e tyre kandidatë për kryetarë të komunave. Në vitin 2021 ishin evidentuar katër (4) parti politike, përderisa në zgjedhje lokale 2025, janë evidentuar dy (2) parti politike. Mirëpo, në këto zgjedhje janë evidentuar edhe tri (3) nisma qytetare që kanë paraqitur kandidatë të cilët kanë probleme me ligjin, përderisa një kandidat tjetër është i pavarur, të cilët formalisht trajtohen si subjekte politike.

Në anën tjetër, IKD evidenton regres sa i përket numrit të kandidatëve me dënime të formës së prerë.

2. Zgjedhjet lokale 2025

Zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës mbahen çdo katër vjet¹. Që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008, në Republikën e Kosovës janë organizuar katër (4) palë zgjedhje të rregullta lokale.

Më 9 qershor 2025, Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, caktoi datën 12 tetor 2025 për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta lokale.²

Për këto zgjedhje lokale që do mbahen në 38 komunat e Republikës së Kosovës, nga KQZ janë certifikuar 93 subjekte politike. Prej tyre, 32 janë parti politike, 32 janë iniciativa qytetare, dy koalicione dhe 27 kandidatë të pavarur.³

2.1.Procesi i certifikimit

Gjatë procesit të certifikimit të kandidatëve për kryetarë dhe anëtarë të kuvendeve komunale për këto zgjedhje, lindën polemika lidhur me certifikimin apo mos certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Kryesisht, këto kishin të bënin me certifikimin e kandidatëve nga radhët e dy subjekteve politike që vinë nga radhët e komunitetit serb në Kosovë. Pra, bëhet fjalë për “Lista Serbe” (LS) dhe “Demokracia Serbe” (DS).

Në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të mbajtur më 21 gusht 2025, Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (Zyra), i rekomandoi KQZ-së që të verifikojë këto dy subjekte politike dhe kandidatët e tyre për kryetarë të komunave dhe për anëtarë të kuvendeve komunale.⁴

Mirëpo pas këtij rekomandimi, nga anëtarë të KQZ, konkretisht përfaqësues të partisë në pushtet në KQZ, shtruan pretendime serioze për përfshirjen e kandidatëve të LS në struktura paralele të Serbisë në Kosovë, e duke theksuar edhe se LS “*është dorë e zgjatur e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq*”. Përderisa për kandidatin nga radhët e DS, Aleksandar Arsenijeviq, u tha se është në kërkim nga organet e rendit të Republikës së Kosovës.⁵

¹ Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, neni 4.2.

² "Presidentja Osmani ka caktuar 12 tetorin e vitit 2025, datë të mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta lokale". 9 qershor 2025. (Shih linkun: <https://president-ksgov.net/presidentja-osmani-ka-caktuar-12-tetorin-e-vitit-2025-date-te-mbajtjes-se-zgjedhjeve-te-rregullta-lokale/>)

³ "Mbi 2 milionë persona me të drejtë vote për zgjedhjet e 12 tetorit". Radio Evropa e Lirë. 6 shtator 2025. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/kqz-certifikon-listen-e-votuesve-per-zgjedhjet-e-12-tetorit/33523448.html>).

⁴ "KQZ-ja nuk e certifikon Listën Serbe për zgjedhjet lokale të tetorit". Radio Evropa e Lirë. 21 gusht 2025. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/lvv-kunder-lista-serbe-certifikim/33509559.html>)

⁵ Po aty.

Në anën tjetër, nga anëtarë tjerë ishte përmendur se verifikimi i listave të kandidatëve ka kaluar nëpër disa institucione dhe asnjë prej tyre nuk ka dhënë ndonjë vërejtje. Derisa kishin theksuar se abstenojnë derisa nuk ka veprime nga ana institucioneve të sigurisë.⁶

Sidoqoftë, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) në KQZ, kishin shpalosur dokumente që sipas tyre argumentonin pretendimet lidhur me kandidatët e këtyre dy subjekteve politike. Përderisa, në mungesë të konsensusit, votimi për certifikim dështoi në të dy këto raste, me 2 vota për, 2 kundër dhe 7 abstenime.⁷

Lidhur me këtë vendim, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vlerëson se vendimi i njëjti është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përmes nenit 22, përcakton se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut aplikohet drejtpërsëdrejti dhe ka supremaci ndaj legjislacionit. Përderisa, e drejta për zgjedhje të lira garantohet sipas nenit 3 të protokollit 1 të kësaj Konvente.

Në kuptim të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), kushti i parë për të mos lejuar pjesëmarrjen e një subjekti politik të marrë pjesë në zgjedhje është përcaktimi me ligj.⁸ Në raport me këtë kriter, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk përcakton në mënyrë të qartë kriteret dhe procedurat për mos lejimin e një subjekti politik të marrë pjesë në zgjedhje. Baza e vetme që mungon certifikimi i subjekteve politike për të marrë pjesë në zgjedhje është neni 16 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili nën nuk jep mundësinë e mos certifikimit si në këtë rast.

Sipas Komisionit të Venecias, një parti nuk mund të mbahet përgjegjëse për veprimet e izoluara të anëtarëve të saj, veçanërisht nëse këto veprime janë në kundërshtim me statutin apo aktivitetet e partisë. Prandaj, veprimet e kryera ose fjalët e shprehura, online ose offline, nga individë të caktuar brenda një partie, kur nuk e përfaqësojnë zyrtarisht partinë, duhet t'u atribuohen vetëm atyre individëve. E njëjta gjë vlen edhe për sjelljen individuale të anëtarëve që nuk është e autorizuar nga partia në kuadër të aktiviteteve politike/publike apo partiake. Në raste të tilla, ndaj këtyre individëve mund të ndërmerren sanksione civile ose penale të përshtatshme. Për më tepër, Komisioni i Venecias thekson se nuk mund të konsiderohet e justifikueshme shpërbërja e një partie politike me arsyetimin se nuk është distancuar nga veprimet apo fjalimet e liderëve apo anëtarëve të saj⁹.

⁶ "KQZ nuk e certifikon Listën Serbe për zgjedhjet lokale të tetorit". Dukagjini. 21 gusht 2025. (Shih linkun: <https://www.dukagjini.com/kqz-nuk-e-certifikon-listen-serbe-per-zgjedhjet-lokale-te-tetorit/>).

⁷ Po aty.

⁸ "CASE OF DICLE AND SADAK v. TURKEY (Application no. 48621/07)". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 87. Strasbourg, 16 qershor 2015. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-155626"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

⁹ "Joint Guidelines of the Venice Commission and OSCE/ODIHR on Political Party Regulation, adopted by the Venice Commission at its 125th Plenary online session (11-12 December 2020)". Këshilli i Evropës. Paragrafët 117-118. Strasbourg, 14 dhjetor 2020. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)032-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)032-e)).

Përderisa, dokumente të tjera të GjEDNj dhe Komisionit të Venecias flasin për një sërë kriteresh dhe procedurash që duhet respektuar në këto situata, e të cilat nuk janë respektuar në rastin konkret. Kështu, IKD gjen se në këtë rast KQZ nuk kishte respektuar Kushtetutën, ligjin, standardet ndërkombëtare dhe praktika e vendosura.

Për më tepër, lidhur me tentimin e KQZ për të lënë këto dy subjekte politike të pa certifikuara, partnerët ndërkombëtarë u shprehën të zhgënjyer dhe i panë këto veprime si shumë shqetësuese.¹⁰

Më 22 gusht 2025, përmes një deklarate, Ambasada e Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, së bashku me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, shprehën shqetësimin e tyre lidhur me tentativat e akterëve politikë për të kufizuar garën mes partive politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë para Zgjedhjeve Lokale të 12 tetorit. Në deklaratë theksohej se *“çdo veprim i tillë për të përjashtuar disa komunitete minon parimet demokratike dhe gërryen besimin në institucionet e Kosovës”*. Duke shtuar se të gjitha procedurat duhet të zhvillohen rreptësisht në përputhje me rregullat dhe mandatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.¹¹

Ndërkaq, në po të njëjtën ditë, përmes një deklarate tjetër, Bashkimi Evropian kishte shprehur zhgënjim për mos-certifikimin e 2 subjekteve politike të serbëve të Kosovës, duke shprehur keqardhje për qëndrimin e marrë nga Lëvizja Vetëvendosje gjatë procesit të certifikimit. Në këtë deklaratë theksohej se karakteri gjithëpërfshirës i zgjedhjeve lokale është kyç për marrëdhënien e ardhshme ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Përderisa kishin shprehur pritshmëritë që institucionet përgjegjëse të sigurojnë që i gjithë procesi i certifikimit, përfshirë edhe ankesat e mundshme, të zhvillohet plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe parimet e Sundimit të Ligjit.¹²

Kurse, disa javë më vonë, konkretisht më 12 shtator 2025, përmes një komunikate, Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë njoftoi se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë pezulluar për një kohë të pacaktuar dialogun e planifikuar strategjik me Kosovën, për shkak të shqetësimeve lidhur me veprimet e Qeverisë në detyrë. Në këtë njoftim thuhej se kjo për shkak të shqetësimeve lidhur me veprimet e qeverisë në detyrë, të cilat kanë rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë, duke

¹⁰ “Statement by Quint and the EU on the registration of parties for Local Elections, August 22, 2025”. Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë. 22 gusht 2025. (Shih linkun: https://xk.usembassy.gov/st_22082025/); “Kosovo: Statement by the Spokesperson on the certification of political parties for local elections”. Bashkimi Evropian. 22 gusht 2025. (Shih linkun: https://www.eeas.europa.eu/eeas/kosovo-statement-spokesperson-certification-political-parties-local-elections_en?utm_)

¹¹ “Statement by Quint and the EU on the registration of parties for Local Elections, August 22, 2025”. Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë. 22 gusht 2025. (Shih linkun: https://xk.usembassy.gov/st_22082025/)

¹² “Kosovo: Statement by the Spokesperson on the certification of political parties for local elections”. Bashkimi Evropian. 22 gusht 2025. (Shih linkun: https://www.eeas.europa.eu/eeas/kosovo-statement-spokesperson-certification-political-parties-local-elections_en?utm_).

kufizuar aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të punuar në mënyrë produktive me Kosovën mbi prioritetet e përbashkëta.¹³

Përderisa, lidhur me çështjen e tentimit për të mos certifikuar Listën Serbe, më 23 shtator u raportua se nga Departamenti Amerikan i Shtetit kjo është cilësuar si përpjekje konkrete për t'ua pamundësuar qytetarëve të Kosovës, dhe në këtë rast serbëve të Kosovës, që të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, si në kuptimin e gjerë ashtu edhe në pozitë udhëheqëse në institucione.¹⁴ Gjithashtu, kjo përpjekje për të penguar pjesëmarrjen e Listës Serbe në zgjedhje, u tha se ishte në mesin e çështjeve që kishin cuar në vendimin për pezullimin e Dialogut të planifikuar strategjik.¹⁵

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) kishte shqyrtuar ankesat e këtyre dy subjekteve politike dhe përmes vendimeve të 23¹⁶ dhe 29¹⁷ gushtit 2025, kishte obliguar KQZ për certifikimin e tyre. Në vendimet e PZAP, mes tjerash ishte konstatuar se vendimet e KQZ nuk ishte dhënë ndonjë arsye për refuzimin e rekomandimit të Zyrës, për certifikimin e subjekteve politike në fjalë. Në vendim, po ashtu thuhej se përgjigja në ankesë e KQZ nuk kishte ndonjë relevancë për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur PZAP. Përderisa, Gjykata Supreme kishte refuzuar ankesat e parashtruara, duke lënë në fuqi vendimet e PZAP.

Në anën tjetër, kujtojmë se praktika e tentimit të mos certifikimit si në këtë rast ishte përsëritur edhe në raport me zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025. Edhe aso kohe, PZAP kishte certifikuar subjektin LS. Kurse, ankesa e LVV ndaj këtij vendimi të PZAP, ishte refuzuar nga Gjykata Supreme. Për këtë arsye, tanimë standardi është vendosur se në këtë mënyrë nuk mund të mos certifikohet një subjekt politik¹⁸.

3. Dekriminalizimi i politikës

IKD ka avokuar vazhdimisht për dekriminalizimin e politikës, në kuptim që personat të cilët kanë probleme me ligjin mos të jenë pjesë e listave zgjedhore dhe bartës të funksioneve të caktuara publike. Problemet me ligjin konsistojnë qoftë në aktakuza aktive të këtyre personave apo dënime të formës së prerë të të njëjtëve.

¹³ "Embassy Pristina Statement Announcing Suspension of Strategic Dialogue with Kosovo, September 12, 2025". Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë. 12 shtator 2025. (Shih linkun: https://xk.usembassy.gov/st_9122025/).

¹⁴ "Zyrtari i DASH-it: Kurti shkeli "vijën e kuqe" me përpjekjen për bllokim të Listës Serbe". KOHA. 23 shtator 2025. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/zyrtari-i-dash-it-kurti-shkeli-vijen-e-kuqe-me-perpjekjen-per-blokim-te-listes-serbe>).

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (A.nr.3/2025). (Shih linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/48254.pdf>).

¹⁷ Vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (A.nr.3/2025). (Shih linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/48262.pdf>).

¹⁸ Instituti i Kosovës për Drejtësi, Lëvizja FOL dhe Iniciativa për Progres. "Integriteti i kandidatëve, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë". Faqe 10. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/integriteti-i-kandidateve-sundimi-i-ligjit-dhe-qeverisja-e-mire/>).

Në gusht të vitit 2021, IKD kishte publikuar raportin lidhur me integritetin e kandidatëve të cilët garonin në zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2021. Asokohe, bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, vlente rregulli se për pozitën e Kryetarit të Komunës apo anëtarit të Asamblesë Komunale nuk mund të kandidojë asnjë person i cili në tri (3) vitet e fundit ishte shpallur fajtor. Dhe kjo pa marrë parasysh dënimin. Ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese ishte nxjerrë në kontekst të interpretimit të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës¹⁹.

Pas asaj kohe, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes konsensusit politik, ka miratuar Ligjin e ri Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ligji në fjalë ka ngritur prapun e problemit ligjor që pamundëson kandidimin. Sipas këtij Ligji, një person nuk ka të drejtë të kandidohet nëse *“është dënuar në tri (3) vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv”*²⁰.

Në demokracitë e konsoliduara, sfera publike shërben si mjet kryesor i shoqërisë për të dalluar krimin prej politikës. Në secilën shoqëri demokratike, zyrtarët e lartë të shtetit, politikanët dhe të gjithë ata që mbajnë përgjegjësi publike, u nënshtrohen normave etike që i përcakton shoqëria. Kësisoj, secili zyrtari që hetohet për krime, publiku i kërkon automatikisht dorëheqjen nga përgjegjësitë publike. Kodi etik, gjithnjë nën vëzhgimin e publikut, funksionon aq mirë sa që rrallë ndodhë që dorëheqja të kërkohet; zyrtarët që janë nën hetime zakonisht dorëhiqen menjëherë, me t'u bërë publike dyshimet për lidhjet e tyre me krimin. Ani pse kodi etik në këtë rast nuk e garanton një shkoqitje absolute të politikës prej krimit, të paktën e krijon përshtypjen e funksionimit të sistemit politik e shoqëror²¹.

Për këtë arsye, përkundër mos ndalesave ligjore, është shumë e rëndësishme që partitë mos të kandidojnë persona të cilët kanë probleme me ligjin. Problemet me ligjin konsistojnë në aktakuza aktive apo në dënime penale, të cilat dënime jo domosdoshmërisht pamundësojnë kandidimin.

Mos kandidimi i personave të cilët kanë probleme me ligjin nuk nënkupton cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Sipas Kushtetutës dhe ligjit, secili person konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia e tij përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Megjithatë, tek publiku duhet të dërgohet një mesazh pozitiv, në atë mënyrë që përderisa problemet me ligjin nuk përfundojnë, partitë politike nuk duhet të kandidojnë persona të cilat kanë probleme me ligjin.

Përtej aspektit ligjor, është shumë e rëndësishme që partitë politike të miratojnë rregulla të brendshme për të respektuar këtë standard, në atë mënyrë që mos të lejojnë kandidimin e personave

¹⁹ Instituti i Kosovës për Drejtësi. *"Integriteti i kandidatëve për kryetarë të komunave - (Analizë e kandidatëve për kryetarë të komunave që kanë probleme me ligjin)"*. Faqe 6-7. Prishtinë, gusht 2021. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/integriteti-i-kandidateve-per-kryetare-te-komunave/>)

²⁰ Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 30.2.2.1.

²¹ Instituti i Kosovës për Drejtësi. *"Dekriminalizimi i politikës në Kosovë"*. Faqe 9. Prishtinë, 21 tetor 2018. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/dekriminalizimi-i-politikes-ne-kosove/>).

të cilët kanë apo kanë pasur probleme me ligjin. Kjo edhe nëse ligjërisht kandidimi i tyre në një pozitë të caktuar është i lejueshëm.

4. Kandidatët në problem me ligjin

Nga 206 kandidatë për kryetarë të komunave, të cilët janë certifikuar nga KQZ, IKD gjen se 8²² prej tyre kanë probleme me integritetin por që në bazë të ligjit në fuqi nuk ua kufizon të drejtën për të garuar në zgjedhje komunale. Shprehur në përqindje i bie se 3.9% e kandidatëve për kryetarë të komunave janë persona të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptim të aktakuzave aktive, apo kanë pasur probleme me ligjin, në kuptim të dënimeve penale.

5. Kandidatët me aktakuza aktive

IKD ka identifikuar gjithsej 4 kandidatë të cilët kandidojnë në zgjedhjet e 12 tetorit 2025 duke pasur aktakuza aktive. Këta 4 kandidatë janë të dënuar nga gjykatat e shkallës së parë, 1 prej tyre është në rigjykim, për 2 të tjerë vendimi nuk është përpiluar ende, kurse një rast është duke u trajtuar nga Gjykata e Apelit. Në vijim, IKD ka paraqitur kandidatët për kryetarë të komunave të cilët kanë aktakuza aktive:

Kandidati	Subjekti Politik	Stadi procedural	Raste	Vepra penale	Viti i aktakuzës	Komuna
Erden Atiq ²³	LVV	Dënuar në shkallë të parë; Rasti në Gjykatën e Apelit	1	Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike	2017	Mitrovicë e Veriut
Sami Lushtaku ²⁴	PDK	Dënuar në shkallë të parë; Rigjykim	1	Krim i organizuar lidhur me veprën penale pengim i te provuarit apo procedurës zyrtare	2016	Skenderaj

²² Shënim: Sami Lushtaku ka edhe aktakuzë aktive edhe dënime të formës së prerë.

²³ "Nuk deklarohet rreth fajësisë i akuzuari se në shtator të 2016-ës ndërpreu transmetimin e seancës së Kuvendit në RTK". Betimi për Drejtësi. 16 shtator 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nuk-deklarohet-rreth-fajesise-i-akuzuari-se-ne%CC%88-shtator-te%CC%88-2016-e%CC%88s-nderpreu-transmetimin-e-seances-se%CC%88-kuvendit-ne%CC%88-rtk/>).

²⁴ "As sot s'u siguruan dëshmitarët e mbrojtur nga EULEX-i, anulohet seanca ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve". Betimi për Drejtësi. 28 prill 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/as-sot-su-siguruan-deshmitaret-e-mbrojtur-nga-eulex-i-anulohet-seanca-ndaj-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve/>).

Shkumbin Demalija ²⁵	Iniciativa Demokracia	Dënuar në shkallë të parë; Aktgjykimi nuk është përpiluar	1	Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar	2018	Deçan
Shukri Buja ²⁶	PDK	Dënuar në shkallë të parë; Aktgjykimi nuk është përpiluar	1	Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar	2018	Lipjan

Tabela 1. Kandidatët të cilët janë me aktakuza aktive.

6. Kandidatët me dënime penale

IKD ka evidentuar 5 kandidatë të cilët kanë pasur dënime penale të formës së prerë. Këta kandidatë, së bashku me veprat për të cilat janë shpallur fajtorë dhe dënimet e shqiptuara, paraqiten në tabelën në vijim:

Kandidati	Subjekti Politik	Raste	Vepra penale	Viti	Komuna	Dënimi
Arbër Emini ²⁷	Kandidat i pavarur	1	Nga keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, rikualifikim në veprën penale “Mashtrimi”	2023	Klllokot	Dënim me gjobë në shumën 200 euro dhe burgim me kusht 90 ditë 9 muaj burgim me kusht dhe dënim me gjobë: 200 euro.
Sami Lushtaku ²⁸	PDK	3	Kanosja;	2021	Skenderaj	Dënim me gjobë: 2,000 euro;

²⁵ "Ish-kryeministri Agim Çeku dhe 9 të tjerët dënohen me nga 1 vit burgim në rastin “Veteranët”, Nuredin Lushtaku dhe Smajl Elezaj lirohen nga akuza". Betimi për Drejtësi. 14 korrik 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryeministri-agim-cek-dhe-9-te-tjeret-denohen-me-nga-1-vit-burgim-ne-rastin-veteranet-nuredin-lushtaku-dhe-smajl-elezaj-lirohen-nga-akuza/>).

²⁶ Po aty.

²⁷ "Apeli kthen në rigjykim rastin e ish-zyrtarit komunal të dënuar për korrupsion". Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ish-zyrtarit-komunal-te-denuar-per-korrupsion/>).

²⁸ "Apeli vërteton dënimet me gjobë ndaj Dardan Gashit, Endrit Shalës, Sami Lushtakut e të tjerëve për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt". Betimi për Drejtësi. 30 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-me-gjobe-ndaj-dardan-gashit-endrit-shales-sami-lushtakut-e-te-tjereve-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>); "Apeli ia vërteton Sami Lushtakut dënimin me 2 mijë euro gjobë për kanosjen e avokatit

			Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve; Arratisje e personit të privuar nga liria	2019 2020		Dënim me gjobë: 1,700 euro; Dënim me gjobë: 12,000
Sokol Bashota ²⁹	PDK	1	Mos-raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	2021	Klinë	6 muaj burgim me kusht dhe 1,200 euro gjobë
Srečko Sparić ³⁰	Srpska Narodna Sloga	1	Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar	2017	Klllokot	10 muaj burgim me kusht
Zafir Berisha ³¹	Bashkimi Demokratik i Prizrenit	2	Sulm ndaj personit zyrtar; Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave	2024 2015	Prizren	6 muaj burgim – zëvendësuar me gjobë: 1,500 euro; Dënim me gjobë: 140 euro

Tabela 2. Kandidatët me dënime të formës së prerë.

Gazmend Halilaj”. Betimi për Drejtësi. 1 qershor 2021. (Shih linkun [Apeli ia vërteton Sami Lushtakut dënimin me 2 mijë euro gjobë për kanosjen e avokatit Gazmend Halilaj - Betimi për Drejtësi](#)); “Arratisja nga QKUK”, *Apeli e lë në fuqi dënimin për Sami Lushtakun kurse e kthen në rigjykim rastin për dy të akuzuar*”. Betimi për Drejtësi. 6 nëntor 2020. (Shih linkun “[Arratisja nga QKUK](#)”, *Apeli e lë në fuqi dënimin për Sami Lushtakun kurse e kthen në rigjykim rastin për dy të akuzuar - Betimi për Drejtësi*).

²⁹ “U dënuan për korrupsion, ish-kryetari i Klinës dhe ish-nënkryetari paguajnë gjobën”. Betimi për Drejtësi. 16 tetor 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/u-denuan-per-korrupsion-ish-kryetari-i-klines-dhe-ish-nenkryetari-paguajne-gjoben/>).

³⁰ “Kryetari i Klllokotit Srečko Spasić dënohet me 10 muaj burg me kusht për keqpërdorim të detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 26 tetor 2016. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-klllokotit-srecko-spasic-denohet-me-10-muaj-burg-me-kusht-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>).

³¹ “Kush je ti që më shënon gjobë he robt...”, *zafir berisha dënohet me 1 mijë e 500 euro për sulmin ndaj zyrtarit policor*”. Betimi për Drejtësi. 9 janar 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kush-je-ti-qe-me-shenon-gjobe-he-robt-zafir-berisha-denohet-me-1-mije-e-500-euro-per-sulmin-ndaj-zyrtarit-policor/>); “Politikë e kriminalizuar”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 293. Dhjetor 2020. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/12/1.-RAPORTI-PDF-WORD-Politike-e-kriminalizuar-1.pdf>).

7. Kandidatët me probleme me ligjin sipas komunave

IKD ka gjetur se nga 38 komunat e Kosovës, në 7 prej tyre ka kandidat të cilët kanë apo kanë pasur probleme me ligjin. Konkretisht, kandidatët të cilët kanë probleme me ligjin janë nga komunat: Skenderaj, Lipjan, Deçan, Killokot, Klinë dhe Prizren dhe Mitrovicë e Veriut.

8. Kandidatët me probleme me ligjin sipas partive

IKD ka gjetur se nga 93 subjekte të certifikuara për këto zgjedhje lokale, në 6 prej tyre paraqiten kandidatë që kanë probleme me ligjin. Në mesin e tyre, 2 janë parti politike, 3 iniciativa qytetare dhe 1 kandidat i pavarur. Në vijim paraqitet tabela me emrat e subjekteve politike dhe numrin e kandidatëve në listat e tyre, që kanë probleme me ligjin.

Subjekti politik	Nr. i kandidatëve
Arbër Emini (<i>Kandidat i pavarur</i>)	1
Bashkimi Demokratik i Prizrenit	1
Lëvizja Vetëvendosje - LVV	1
Partia Demokratike e Kosovës – PDK	3
Iniciativa Demokracia	1
Srpska Narodna Sloga	1

Tabela 3. Lista e subjekteve politike dhe numri i kandidatëve që kanë probleme me ligjin.

Me këtë rast, IKD gjen se subjektet e tjera, të cilat nuk janë të përfshira në tabelën si më lartë, bazuar në monitorimin e IKD, nuk kanë kandiduar asnjë person i cili ka probleme me ligjin.

9. Kandidatët me probleme me ligjin sipas veprave penale

IKD ka gjetur se kandidatët për kryetarë të komunave në zgjedhjet e 12 tetorit 2025 të cilët kanë probleme me ligjin janë akuzuar në 12 raste, për gjithsej 10 vepra penale të ndryshme penale.

Nga numri total i rasteve, 4 prej tyre kanë të bëjnë me vepra penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe një rast për krim të organizuar. Po ashtu, nga një (1) rast është për veprën penale mashtrimit, armëmbajtjes pa leje, kanosjes, sulmit ndaj personit zyrtar, arratisje e personit të privuar nga liria, heqjes apo dëmtimit të vulave zyrtare ose të shenjave, si dhe asgjësimit, dëmtimit ose heqjes së instalimeve publike.

10. Krahasoni me zgjedhjet paraprake

Në tabelën në vijim, IKD ka bërë krahasimin e gjetjeve të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit 2021 me zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025, duke matur progresin dhe regresin në këtë fushë.

Çështja	Zgjedhjet lokale 2021	Zgjedhjet lokale 2025	Progres/Regres
Nr. i kandidatëve në problem me ligjin	10	8	Progres
Nr. i kandidatëve me aktakuza aktive	9	4	Progres
Numri i kandidatëve me dënime penale	2	5	Regres
Numri i komunave në të cilat garojnë kandidatë me probleme me ligjin	9	7	Progres
Numri i partive politike që përfshijnë kandidatë që kanë probleme me ligjin	4	2	Progres
Numri i subjekteve politike që përfshijnë kandidatë që kanë probleme me ligjin	4	6 ³²	Regres

Tabela 4: Krahasoni i zgjedhjeve lokale të vitit 2021 me zgjedhjet lokale të vitit 2025.

³² Shënim: Një prej tyre është kandidatë të pavarur.